



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5301 /2025
Data : 14.07.2025

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e gjashtë -VI- për vitin 2025 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 18.06.2025 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028.
3. Planit Zhvillimorë Komunal.
4. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- te disa projekte kapitale paramasat kanë dalë më të larta se sa buxhetin që e kemi , kështu që propozoj që në rend të punës të hyjë kërkesa për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore investime kapitale. Me datë pesë qershor kemi pranuar një të hyrë nga një shpronësim në shumë mbi gjashtëqind mijë euro, kështu që propozoj që të hynë në rend të punës propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025.

Nexhmedin Daci thekson:- kërkoj që të hiqet nga rendi i punës Planit Zhvillimorë Komunal për shkak se ende nuk e kemi pranuar pëlqimin prej Ministrisë

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka, pikat shtesë të cilat i propozoj drejtoresha z. Lindita Ballazhi i hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri. Propozimin që pika e tretë e rendit të Planit Zhvillimorë Komunal të hiqet nga rendi i punës e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATU RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028.
3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.
4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksonit të të hyrave vetanake për vitin 2025.
5. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore investime kapitale.
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Korniza afatmesme buxhetore 2026-2028.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- kemi mbajtur dëgjimet buxhetore dhe kemi marr propozime nga qytetarët dhe i keni si material shtesë. Në krahasim me vitet e kaluara gjatë këtij viti ka pasur ndryshime të qarkores së parë buxhetore dhe gjatë këtij viti kemi informacione se do të pranohen tri qarkore buxhetore. Si organizatë buxhetore do të kemi edhe afatin e ankesave dhe disa procedura që të gjitha i gjeni në kornizën afat mesme buxhetore. Për vitin 2026 buxheti parashikohet që të jetë në shumë 4,234,682.00 €. Për vitin 2027 buxheti parashikohet që të jetë në shumë 4,457,136.00 €. Për vitin 2028 buxheti parashikohet që të jetë në shumë 4,672,491.00 €. Kemi parashikuar se si do të jetë inkasimi i të hyrave evtanake duke i ndarë ato në të gjitha kodet ekonomike dhe llojin e të hyrave vetanake. Projektioni është për tre vite, për vitin 2026 vlerësohet të jetë 356,720.00 €, për vitin 2027 vlerësohet të jetë 383,895.00 €, për vitin 2028 vlerësohet të jetë shuma prej 385,721.00 €. Në qarkoren e parë buxhetore në sektorin e shëndetësisë kemi një rritje të stafit prej trembëdhjetë pozitive. Materialin e keni pranuar me kohë dhe përveç materialit të cilin e keni pranuar diçka të veçantë nuk kam për me shtuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KORNIZA AFAT MESME BUXHETORE 2026-2028 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Propozim vendimi për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026.

Kryesuesi thekson:- vitin e kaluar për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025 në komision kanë qenë anëtarët e Komitetit për Politikë e Financa dhe propozoj që përsëri të mbesin anëtarët e njëjtë në këtë komision. Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të Komunës Hani i Elezit nga tejkalimi i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- me datë pesë qershor është tejkualuar projeksioni për të hyrat vetanake. Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2025 është në shumë prej 339, 719 €. Komuna Hani i Elezit ka tejkualuar këtë projeksion, gjegjësisht prej muajit janar deri më datë 05.06.2025 ka inkasuar prej të hyrave direkte dhe indirekte në shumë prej 1,098,944.32 €. Tejkalimi fillestarë është në realizim e sipër në shumë prej 90,513.29 €, ndërsa tejkalimi i dytë i projeksionit të të hyrave vetanake për vitin 2025 për të cilin kërkojmë aprovimin e juaj për alokim është në shumë prej 668,712.03 €. Duke marr parasysh këtë shumë ne i kemi ndarë në bazë të nevojave që janë shfaqur nëpër drejtori apo nën-programe buxhetore dhe në material i keni të detajuar mjetet financiare se u do të shpërndahen.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT NGA TEJKALIMI I PROJEKSIONIT TË TË HYRAVE EVTANAKE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore investime kapitale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- rialokimi i mjeteve në komunën e Hanit të Elezit në kategorinë buxhetore investime kapitale është në shumë prej 34,500.00 € nga fondi dhjetë apo granti qeveritarë. I kemi tre nën-programe buxhetore, nën-programi parë ka të bëjë me shërbimet publike parandalimi dhe inspektimi i zjarreve që prej projektit ndërtimi i deponisë për mbetjet e ngurta inerte në shumë prej njëmijë euro do të rialokohen në projektin shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit. Në kuadër të nën-programit buxhetorë planifikimi urbanë dhe inspeksioni janë disa projekte duke përfshirë ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojërave në Han të Elezit dhe fshatrat Gorancë, Paldenicë, Seçishtë në shumë prej 5000 €. Ndërtimi i parkut në fshatin Paldenicë në shumë prej 7000 €. Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë në shumë prej 5000 €. Ndërtimi i rrugës Hani i Elezit –Dimcë në shumë prej 3000 € . Rregullimi i rrugës Fujëza –Vërtomicë në shumë prej 5000 €. Shtrimi me zhavorr i rrugës prej burimit të fshatit Seçishtë

deri te Lloka në shumë prej 3000 €. Të gjitha këto rialokohen në projektet ndërtimi (rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugës në fshatrat Palenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik në shumë prej 10 000.00 €. Shtrimi me kupëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik, në shumë prej 18,000.00€. Në kuadër të nën-prgramit administrata e arsimit, ndërtimi i objektit SHFMU në lagje të Re në shumë prej 3000 €, Ndërtimi i çerdhes në Lagje të Re në shumë prej 2500 €, rialokohen në projektin rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML –Ilaz Thaçi, SHFMU-Kështjella e Diturisë dhe SHMFU-Veli Ballazhi, Institucioni parashkollorë Ardhmëria” në shumë prej 5500 €.

Sherif Berisha thekson:- rruga prej Paldenicës që vjenë për Han të Elezit është pjesa e Kazermës e cila nuk është më shumë se treqind metra gjatësi kërkoj që të hapet kjo rrugë dhe ishin eliminuar shtëpitë të cilat kanë mbetur si gërmadha

Hyriete Isufi thekson:- shtrimi me kupëza betoni i rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat Paldenicë, Seçishtë, a parashihen në Han të Elezit me u ndërruar këto që janë, është mirë me na dhënë pak sqarim.

Nexhmedin Daci thekson:- emërtimi është i përgjithshëm e nuk do të thotë që në Han të Elezit por emërtimi është në këtë formë pra është si kod. Ndërsa këtë që e propozoj z. Sherif Berisha është pak problem se vetëm me iniciuar procedura merr kohë dhe është pak problem në këtë vit. Ka kërkesa edhe prej banorëve të fshatit Dimcë por edhe banorëve të fshatit Dimcë por ka mbetur me u diskutuar për shkak se një pjesë është e planifikuar për park dhe një pjesë për ndërtimin e QKMF-së. Demolimi i shtëpive të mbetura duhet të bëhet prej Ministrisë për shkak se është projekt i tyre dhe nëse Ministria kërkon që komuna me i hequr nuk është problem i heqim.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU KËRKESA PËR RIALOKIM TË MJETEVE NË KATEGORINË BUXHETORE INVESTIME KAPITALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- është mirë që te shëndetësia po shtohet numri stafit.

Xhevahir Dernjani thekson:- është mirë që të vendosen shtyllat e betonit dhe ndriçim prej te Kori deri te rruga dy korriku. Kemi një kërkesë prej z.Tefik Dernjani për rregullimin e një muri mbrojtës.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket murit mbrojtës do të shikohen mundësit financiare.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:40.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

